




Programi i Partneritetit Evropian me Komunitat

Raporti i shtatë tremujor

1 tetor-31 dhjetor 2012.



Program finansira EU

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program finansira EU



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program evropskog partnerstva sa opštinama

2 Përmbledhje

Zgjedhjet e mbajtura në maj të vitit 2012 edhe më tutje në masë të madhe ndikojnë në implementimin e Programit të Partneritetit Evropian me komunat EU PROGRES. Efikasiteti në zbatimin e projektit është zvogëluar për shkak të prekomponimit të koalicioneve qeverisëse në nivelin lokal, në mënyrë që përbërja e tyre të reflektojë përbërjen e koalicionit në nivelin republikan.

EU PROGRES-i deri në fund të vitit 2012 ka kontraktuar implementimin e 187 projekteve: implementimi i 85 (45%) projekteve ka përfunduar, që paraqet rritje prej 5% në krahasim me periudhën raportuese paraprake; implementimi i 47 (25%) projekteve është zhvilluar në tërësi sipas planit, përderisa implementimi i 39 (21%) projekteve është zhvilluar me vonesë e cila me vete bart rreziqe të vogla; implementimi i gjashtë (3%) projekteve gjendej në fazë kritike; implementimi i një projekti është ndërprerë gjatë kësaj periudhe, me çka numri i projekteve të ndërprera ka arritur numrin dhjetë. Deri më tani gjithsej janë paguar 9.343.373,64 euro ose 57% të buxhetit të përgjithshëm, nga të cilat 1,8 milion euro në tremujorin e katërt. Norma e pagesës në këtë periudhë është rritur për gati 45% në krahasim me normën mesatare të pagesës gjatë tre tremujorëve të mëparshëm, kurse EU PROGRES duke iu falënderuar kësaj dinamike ka arritur planin për vitin 2012.

Ka ardhur deri tek ndryshimet pozitive në përpjekjet e Programit për të lehtësuar investimet dhe punësimin. Qyteti i Leskocit pas ndërtimit të infrastrukturës së brendshme në Zonën e gjelbër ka filluar me punimet në rrugën e tërthortë, projekt të cilin me 46 milion dinar e përkrah ndërmarrja Putevi Srbije. Përveç kësaj ka filluar procedura e dhënies së lejeve për ndërtim për tri kompani të cilat planifikojnë të investojnë rreth 3,5 milion euro. Këto investime fillestare, bashkë me fabrikën për përpunimin e drurit në Medvegjë, duhet të kontribuojnë në hapjen e 350 vendeve të reja të punës gjatë dy viteve të ardhshme. Përveç kësaj, dokumentacioni planor për Zonën industriale Bunushevc në Vranjë dhe projekti kryesor i rrugës deri tek zona, që janë përgatitur në kuadër të EU PROGRES-it, janë parakushte për tërheqjen e investitorëve në këtë zonë. Prodhuesi italian i këpucëve Geox dhe prodhuesi i mobiljeve Ditra kanë publikuar planet e veta për të investuar 30 milion euro në zonën Bunushevc dhe të hapin 1.650 vende të reja të punës.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012 është paralajmëruar hapja e vendeve të reja të punës edhe në sektorin publik, pasi që janë rritur kapacitetet e shkollave, klinikave dhe çerdheve: për shembull, çerdhet në Tutin dhe në Rashkë do të punësojnë 29 persona. Duke iu falënderuar projektit i cili përkrah zhvillimin e biznesit përmes Qendrës së Biznis inkubatorit (BIC) në Vranjë janë hapur katër vende të reja të punës, me katër vende të punës që janë hapur më herët. EU PROGRES-i ka përkrahur projektin e ri me Qendrën e Biznis Inkubatorit i cili përmes programit virtual të biznesit për Romët duhet të sigurojë 30 vende të reja të punës shtesë.

Është shënuar përparim edhe në fushën e zhvillimit shoqëror: tri çerdhe të reja në Rashkë, në Tutin dhe në Ivanjicë do të përkujdesen për rreth 430 fëmijë, me çka në masë të dukshme do të zvogëlohen listat ekzistuese të pritjes; është ofruar ndihmë juridike pa pagesë për më shumë se 1.000 njerëz, me çka, në këtë periudhë, është mundësuar qasja ndaj të drejtave themelore, në mënyrë parësore ndaj bursave; me ndërtimin e laboratorit medicinal në Kurshumli për 30% është zvogëluar koha e nevojshme për zbatimin e testeve për shkak të organizimit më të mirë të hapësirës dhe mundësisë së zbatimit të njëkohshëm të analizave. Disa projekte kanë qenë të përqendruar në përmirësimin e kualitetit të jetës së pupullatës Rome: në vendbanimin e Vranjës të quajtur Qoshka 30 familje kanë arritur qasje ndaj ujit të pijshëm; 90 Romë në Surdulicë kanë marrë letërnjoftimet pa pagesë; 50 Romë parashkollor dhe nxënës në Vlladiçin Han kanë marrë pjesë në punëtoritë edukative dhe kreative për të arritur rezultate më të mira në shkollë.



Program finansira EU



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



Sprovodi program



Program evropskog partnerstva sa opštinama

Edhe pse numri i këshilltareve në kuvende komunale është rritur, zgjedhjet kanë sjellur deri tek ngecja e aktiviteteve lidhur me barazinë gjinore: statusi i mekanizmave të vendosur tanimë për barazinë gjinore (MRR) në shumë komuna ka qenë i paqartë dhe shumë prej tyre nuk kanë qenë funksional. Për këtë arsye EU PROGRES ka vazhduar të përkrahë 12 MRR në Serbinë jugperëndimore dhe Qarkun e Toplicës. Programi në Zhitoragjë ka ndihmuar aprovimin e Kartës evropiane për barazinë e femrave dhe burrave në jetën lokale. Shtatë komuna kanë hapur linjën buxhetore për barazi gjinore, që do të mundësojë punë të papengueshme të mekanizmave lokal.

EU PROGRES ka vazhduar me projekte të cilat do të zvogëlojnë ndikimet negative në ambientin jetësor: ndotja e ajrit do të jetë e zvogëluar duke iu falënderuar ngrohjes së institucioneve publike në Medvegjë dhe në Prijepolje përmes kazaneve me biomasë; duke iu falënderuar ngrrohtoreve të reja ose të rikonstruara (në Novi Pazar, Tutin dhe Rashkë) do të zvogëlohet emisioni i karbon dioksidit, kurse pasojat negative në kualitetin e ajrit janë vënë në minimum. Disa projekte do të sjellin deri te përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe llogarive të zvogëluara të rrymës (në Preshevë, Vlladiçin Han, Bllace, Rashkë dhe Tutin).

Përfundimisht, puna në menaxhimin e mirë si aspekt i tërthortë i Programit gjithashtu jep rezultate: dhjetë komuna kanë harmonizuar hapat e ardhshëm për aplikimin e aspektit të menaxhimit të mirë në kuadër të projekteve të vogla dhe të mëdha të infrastrukturës; është aplikuar organizimi i procesit për tre projekte të mëdha të infrastrukturës (deponia në Banjicë. Qendra regionale për prodhimin e frutave në Qarkun e Pcinjës dhe Qendra për zhvillimin e Peshterit), përdërisa reforma e ashtuquajtur e „pastër“ e menaxhimit të mirë vazhdon me përcaktimin e detyrave konkrete të zyrtarëve lokal në Ivanjicë. E tërë kjo do të kontribuojë në rritjen e transparencës, përgjegjësisë, efikasitetit, eficiencës dhe jodiskriminimit në trupat komunal dhe institucione.

Gjatë këtij tremujori implementimi i disa projekteve ka vërtetuar rreziqet e supozuara në fillim: kualitet i dobët i dokumentacionit teknik dhe planor, çështjet lidhur me pronësinë ndaj tokës, sfidat lidhur me sigurimin e mjeteve komunale për sufinansim, ankesat në rezultatet e prokurimeve publike- e tërë kjo ndikon në zbatimin e papengueshëm të Programit. Kjo periudhë, posaçërisht edhe më tej ka qenë i karakterizuar me rreziqet lidhur me zgjedhjet: në shumë komuna është ndryshuar përbërja e Ekipeve për zbatimin e projekteve (TSP) kurse në disa komuna ato ende nuk janë emëruar, gjë që ngadalëson përparimin në zbatimin e aktiviteteve. Nga ana tjetër, kapacitetet e pranuesve të ndihmës së pakthyeshme janë forcuar. Pranuesit të cilët kanë zbatuar projekte të përkrahura nga Fondi për pjesëmarrje 1 (CIF 1) e të cilëve iu është lejuar ndihma e pakthyeshme përmes CIF 2 me sukses kanë kaluar revidimin, me çka kanë dëshmuar që kanë përmirësuar efikasitetin në zbatimin dhe menaxhimin e projekteve.

Mungesa e personave të kualifikuar edhe më tej do të paraqesë sfidë në Serbinë jugore dhe jugperëndimore. Nga fundi i vjeshtës janë publikuar rezultatet përfundimtare të Regjistrimit nga viti 2011 të cilët kanë treguar se në Rajonin e përgjegjësisë së (PO) të EU PROGRES-it jetojnë 100.000 persona më pak, pasi që të rinjtë dhe të shkolluarit nuk kthehen në vendlindjet e tyre pas studimeve.